



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Ersekë, më ____ . ____ . 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ Datë ____ . ____ . 2026

"PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË NJË PRONE PRIVATE, ME QËLLIM NDËRTIMIN E KËNDIT TË LOJËRAVE PËR FËMIJË "KOLOVAJZA 2"

Në mbështetje të Nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik", i ndryshuar me ligjin Nr. 2/2016, datë 10.03.2016, Nr 11/2020, datë 12.02.2020, Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e datës ____ / ____ /2026.

PROPOZOJ

1. Të miratoj propozimin për dhënie e dakordësisë për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të një prone private, me qëllim ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë "Kolovajza 2".
2. Ngarkohet për zbatimin e legjislacioni Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e D.P.ZH.T.M, Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Kolonjë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar .

KRYETARI
ERION ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 484 Prot

Ersekë, më 24.07.2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

Nr. __ , Datë __. __. 2026

"PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË NJË PRONE PRIVATE, ME QËLLIM NDËRTIMIN E KËNDIT TË LOJËRAVE PËR FËMIJË "KOLOVAJZA 2"

KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË

Të nderuar Këshilltarë!

Ky relacion hartohet në mbështetje të Nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik", i ndryshuar me ligjin Nr. 2/2016, datë 10.03.2016, Nr 11/2020, datë 12.02.2020, Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar. Çdo akti tjetër ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon procedurat e shpronësimit për interes publik.

I. Qëllimi i relacionit

Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike paraqet këtë relacion për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Kolonjë, me qëllim marrjen e dakordësisë për fillimin e procedurave administrative dhe ligjore për shpronësimin e një pasurie private, e cila rezulton e domosdoshme për realizimin e investimit publik "Ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë "Kolovajza 2" të miratuar me Vendimin Nr 18, datë 27.01.2026 të Këshillit Bashkiak Kolonjë dhe të konfirmuar bazueshmërinë ligjore me Shkresën Nr.188/1 të Prefektit të Qarkut Korçë.

Ky investim është planifikuar të realizohet në funksion të interesit publik, me synim përmirësimin e infrastrukturës rekreative, krijimin e hapësirave të sigurta për zhvillimin social dhe fizik të fëmijëve, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës së komunitetit.

II. Gjendja faktike

Nga verifikimet e kryera nga Drejtoria e D.P.ZH.T.M të Bashkisë Kolonjë rezulton se sipërfaqja e nevojshme për realizimin e investimit ndodhet mbi një pasuri në pronësi private me këto të dhëna:

Pronarët: Drita Maluka; Ismail Maluka; Luan Maluka; Medi Maluka; Robert Maluka; Safije Maluka; Shpresa Maluka; Vera Maluka; Drita Maluka; Ismail Maluka; Luan Maluka; Medi Maluka; Robert Maluka; Safije Maluka; Shpresa Maluka; Vera Maluka

Zona kadastrale: 1594

Numri i pasurisë: 5/58

Sipërfaqja totale e pasurisë që kërkohet të shpronësohet : 1740 m²

Vendndodhja: (ish kolovajzat e para viteve 1990).

Indeksi i hartës: ER-E-5

Pasuria e mësipërme është identifikuar si e vetmja sipërfaqe që plotëson kushtet urbanistike, funksionale dhe teknike për realizimin e këtij investimi publik që ishte parashikuar .

Përzgjedhja e truallit ku propozohet ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë është bërë mbi bazën e interesit më të lartë publik, duke marrë në konsideratë funksionin urbanistik të zonës, aksesueshmërinë për qytetarët, sigurinë e fëmijëve, si dhe traditën e përdorimit të kësaj hapësire. Është shqyrtuar mundësia e realizimit të investimit në lulishten e qytetit, pas vlerësimit teknik dhe funksional është arritur në përfundimin se hapësira e lulishtes shërben si zonë e gjelbër publike me funksione rekreative të përgjithshme dhe ruajtja e karakterit të saj është në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm urban.

Trualli i propozuar për ndërtimin e këndit të lojërave përkon me territorin ku, historikisht, para viteve 1990, ka funksionuar këndi i lojërave të qytetit. Rikthimi i këtij funksioni në të njëjtën hapësirë përbën një rivitalizim të një funksioni publik tradicional, duke rikthyer në përdorim një zonë që ka shërbyer për breza të tërë fëmijësh dhe duke ruajtur vazhdimësinë historike e sociale të qytetit të Ersekës.

Ky propozim është në përputhje me kompetencat e Bashkisë, të parashikuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, mirëmbajtjen e hapësirave publike, parqeve, lulishteve dhe infrastrukturës rekreative në funksion të komunitetit. Gjithashtu, ai respekton parimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke garantuar përdorimin racional të tokës dhe realizimin e investimeve që i shërbejnë interesit publik.

Për rrjedhojë, ndërtimi i këndit të lojërave në ish-hapësirën historike të tij përfaqëson zgjidhjen më të përshtatshme nga pikëpamja urbanistike, funksionale, sociale dhe administrative të sigurt e cilësor për fëmijët e Bashkisë Kolonjë.

III. Arsytimi teknik dhe juridik

Ndërtimi i këndit të lojërave “Kolovajza 2” përbën një investim me karakter publik dhe social, i cili synon krijimin e një ambienti të sigurt dhe funksional për fëmijët e kopshteve, shkollave dhe komunitetit, shtimin e hapësirave rekreative dhe publike në territorin e Bashkisë Kolonjë duke përmirësuar edhe standardeve të jetesës.

Për shkak se prona ku parashikohet realizimi i investimit është pronë private, ndërtimi i objektit nuk mund të realizohet pa përfundimin e procedurave ligjore të shpronësimit sipas legjislacionit në fuqi.

Në përputhje me Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik”, ”, i ndryshuar me ligjin Nr. 2/2016, datë 10.03.2016, Nr 11/2020, datë 12.02.2020 shpronësimi përbën një mjet ligjor që përdoret vetëm kur ekziston një interes publik i ligjshëm, i argumentuar dhe i domosdoshëm, kundrejt shpërblimit të drejtë të pronarit sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.

Dhënia e dakordësisë nga Këshilli Bashkiak nuk përbën aktin e shpronësimit, por autorizon fillimin e procedurave administrative për përgatitjen e dokumentacionit teknik, juridik dhe financiar që do t’i përcillet institucioneve kompetente (Agiensia Shtetërore për Shpronësim) për vijimin e procedurës së shpronësimit.

IV. Efektet financiare

Vlera paraprake e shpronësimit do të përcaktohet mbi bazën e aktit të ekspertimit dhe metodologjisë së vlerësimit të pasurive të paluajtshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Burimi i financimit për investimin do të jetë sipas Shkresës Nr 18133/1, datë 24.12.2025 të Ministrisë së Financave, me Lëndë “Detajimi i fondit të grandit të bazuar në performancën për bashkitë për vitin 2025, me Burim Financimi nga Buxheti i Shtetit” me vlerën **5,101,123.60** lekë. Burimi i financimit të tokës e cila është për të shpronësuar do të jetë nga buxheti i bashkisë.

VI. Dokumentacioni shoqërues i Relacionit

- Planvendosjen e pasurisë për shpronësim
- Dokumentacionin e identifikimit të pasurisë
- Projekti
- Specifikimet teknike të projektit e këndit të lojërave për fëmijë “Kolovajza 2”


V. Konkluzioni

Duke qenë se realizimi i investimit “Ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë ‘Kolovajza 2’” përfaqëson një interes publik të rëndësishëm për komunitetin dhe se prona mbi të cilën do të ndërtohet është në pronësi private, vlerësohet e domosdoshme fillimi i procedurave ligjore të shpronësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Kolonjë miratimi i vendimit për dhënien e dakordësisë për fillimin e procedurave të shpronësimit të pasurisë private me të dhënat Zona kadastrale 1594, Numri i pasurisë 5/58, Sipërfaqja totale e pasurisë që kërkohet të shpronësohet 1740 m², vendndodhja (ish kolovajzat e para viteve 1990), Indeksi i hartës: ER-E-5, në funksion të realizimit të investimit publik “Ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë ‘Kolovajza 2’”.

Konc: Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike

O.Lifo



ASHK për Institucionet

Kerkitim pasurive

1 - 1 pasuri

Kyefëdija

Kërko

Aktiva e re

Dokumentet e postuara

Ministria e Tregëtisë

Pjesë

Filtro

Kerkitim sipas indeksave

Zona kadestrale

1594

Indeksi i hartës

Numri i pasurisë

5 / 58

Volumi

Faqja

Kerkitim sipas pronarëve

Person fizik

Person juridik

Nr. Reference

NID/NIPT

Emri

Adresa

Mbiemri

Kerkitim sipas adresës

Brethi

Qyteti/rrati

Rrugja/Lajla

Pallati/Codina

Shkalla

Apartamenti

Regjistri i pronës publike

Kodi

Lloji i institucionit

Institucioni

Institucioni ne varesi

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh

Zgjidh


Zgjidh

Zgjidh

Ky sistem elektronik nthenhet aktualisht nga operatorët ekonomik: SoftSolution s.p.a dhe Rastex s.p.a

Ngarkim për 0.07 sekonda

Dokumentet e postuara



1-1 pasuri

Nr	Zona	Volume	Fagja	Indeksi / hartë	Nr pasurisë	Q	Shtet	Q	Prokur	Pishtar
1	1 594	11	149	BR-E-5	5/58	Z.VR.PP KORÇE DEVOLL-KOLONJE	Albanc		DEJTA MALIQA, ISMAIL MALIQA, LUAN MALIQA, MEXI MALIQA, DORIAN MALIQA, SADIE MALIQA, SHIPRESA MALIQA, VERA MALIQA, DEJTA MALIQA, ISMAIL MALIQA, LUAN MALIQA, MEXI MALIQA, ROBERT MALIQA, SADIE MALIQA, SHIPRESA MALIQA, VERA MALIQA	1539

Nafinim për 0.07 sekonda

557812.867
4467304.468



1594, nr. pasurisë 5/58, volum 11, faqe 149, indeksi hartes ER-E-5, qyteti Erseke sip. 1740 m, <https://geoportal.asip.gov.al/otom>


Data e Printimit: 21.07.2026

557812.867
4467304.468



557812.867
4467304.468

<https://geoportal.asip.gov.al/otom> te dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përfjetëse. Përfjetësia për saktesinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.





Legjenda

- Ndërtesa
- Kadastreale
- (AI BSCAD)
- Parcelet
- Kadastreale
- (AI BSCAD)
- Shtresë
- P=6
- di 1
- 1 m

Rendi 1 (Kufi)

- Sistemi koordinativ: KRQJSH
- Projektim: KRQJSH

557812.867
4467304.468



BASHKIA KORONJE
KENDITË DORËVATË DËR FIDELITËT,
QYTETI BASHKIA KORONJE,
VITI 2021

Projektes

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT
E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Emertimi i llojes

DEMAET E HRALES

1:500

A3

PROJEKT ZBATIMI



BASHKIA KOLONJE

KENDITËDORË AVË PËR FUNKTET
Q' TËN ERSËKË BASHKIA KOLONJE
VITI 2021

Projektes

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT
E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Enefinimi i llojes

DETAJET E HAPLES



1:500

A3

PROJEKT ZBATIMI

SPECIFIKIME TEKNIKE



Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

1	Loder suste me forme gomari 1.Produkti do të prodhohet nga çeliku me sustë me tërheqje të ngurte. 2.Produkti do të prodhohet nga materiali polietileni i vetëngjyrosur. 3.Lidhja e produktit duhet të bëhet me ndihmën e një fllanxhe (fletë) U dhe me vidë të lidhura midis sustave dhe figurës së gomarit, te cilat do të jenë të mbuluara me kllaf për të parandaluar kapjen e gishtit dhe dorës. 4.Pesha e produktit duhet të jetë min.10 kg. 5.Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore. 	Cope	2
2	Lekundese dyshe 1- Produkti duhet të formohet nga 4 shtylla të vendosura dy e nga dy paralele te vendosura 120 cm ne distance nga njera-tjetra dhe shtyllat te jene 300 cm te larta me material te galvanizuar dhe te gjitha keto elemente qe formojne lekundesen gjithashtu te kene kaluar procesin e lyerjes ne furre. 2-Largesia e shtyllave ne produkt do te jete 300 cm (paralelet). Ne tubin lidhes do te kapen gjithsej 4 kapesë metalike, dy per cdo lekundese ku do te varen zinxhire te galvanizuar 6 mm (zinxhiri do te vendoset me dy rreshta per te parandaluar bllokimin e gishtave). Sedilja e produktit do te jete prej materiali Polietileni me nje rrip mbrojtës përpara për siguri të mbyllur në 3 ane. 3-Sedilja do te kete permasat me gjerësi dhe gjatësi 48x42 cm 	Cope	2

SPECIFIKIME TEKNIKE


Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

dhe lartesi 33 cm.
Sedilja duhet te jete ne



hapesiren e saj ulese 35 cm.

4-Në sipërfaqen e përparme të sediljes së lëkundeses duhet të përdoren tamponat gome që thithin goditjet për të parandaluar



përplasjet.



Lëndët ngjyruese të

përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore.

Lekundese teke

1- Produkti do te formohet nga 3 shtylla te galvanizuar, ku 2 prej tyre do te kene lartesine 60 cm nga toka dhe shtylla qe do vendoset ne mes tyre do te jete e gjate 320 cm.

Materiali i shtyllave te jete i galvanizuar dhe te jete i nenshtruar procesit te lysterjes ne furre.



3

Cope

2


SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

Sedilet ulese duhet te jene te prodhuara nga Polietileni me tekniken e fryerjes me permasa 40 x 20 x 25 cm dhe trashesia e shtyllave ne forme tubi te jete 90mm

Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore.

Permasat fikse jane ne vizatimet bashkangjitur.




Loder me pamje natyre

Lodra me pamjen e natyres do te jete e perbere nga disa pjese te cilat do te montohen se bashku dhe do te formojne lodren me siperfaqe 45 m2. Pika me e larte e saj do te jete 4.5 m. Disa nga elementet e saj si

platforma katrore do te jete me permasa 115 x 115 cm, e cila do te sherbeje si platforme ku do te kryhet montimi i pjeseve perberese te produktit.

Rreshkiteset qe do te montohen do te jene njera me permasa 220 cm te montuara ne lartesi 120 cm nga toka, gjeresia e seksionit rreshkites te jete 45 cm rreshkitesja tjeter te jete me permasa 280 cm e vendosur 170 cm nga toka, gjeresia e seksionit rreshkites te jete 45 cm, ndersa rreshkitesja tjeter ne forme spirale te jete e vendosur



Cope

2

SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

180 cm nga toka dhe gjerësia e saj ne fillim te jete 115 cm. Te gjitha rreshkiteset te jene te perbera nga materiali i Polietilenit.

Pjeset

dalese te rreshkiteseve

do te futen ne toke dhe do te betonizohen. Nje pjese tjeter perberese e ketij produkti eshte edhe tuneli ne forme tubi 100 cm i gjate ,i cili do te sherbeje si pjese hyrese per tek rreshqiteset. Tubi ne forme tuneli nuk duhet te kete siperfaqe qe demtojne trupin e njeriut. Paneli i rreshkitjes se tunelit do te fiksohet ne shtyllat ,


pjese perberese e ketij produkti. Te gjitha rreshkiteset do te fiksohen ne dysHEME nga pjesa e daljes me bulona te galvanizuara. Elemente te tjere te kesaj lodre do te jene edhe kangjellat

rrethuese me

motive natyre, shkallet ngjitese dhe figura lulesh dhe kafshesh te pershtatshem per konceptin e kendit te lojrave, pjesa e kulmit do te jete me element qe ka si objekt pemet. Shkallët do të prodhohen në atë mënyrë që të mund të arrijnë 100 cm diferencë niveli.


Hapat do të jenë prej llamarine te galvanizuar . Lartësia e shkallës është min. 17 cm, gjerësia e shkallës min. 19 cm. gjerësia e shkallëve duhet të jetë min 64 cm. Shkallet dhe tubat e shkalleve do te mbulohen me PVC. Te gjitha elementet perberes te kesaj lodre do te jene prej Polietileni dhe lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore.

Te gjitha elementet dhe permasat e tyre jane sipas figurave ne tabelen.



SPECIFIKIME TEKNIKE




Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

			
5	Loder shumengjyreshe	Cope	2

SPECIFIKIME TEKNIKE



Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

Produkti shumengjyresh do te jete i formuar me nje siperfaqe prej 66 m2. Pika me e larte e tij do te jete 4m. Elemente perberes te ketij produkti si: shtyllat, shkallet, rreshkiteset, platformat, kangjellat, figurat me element argetues do te jene te perbera nga material Polietileni linear me densitet te ulet dhe te galvanizuara. Produkti do te kete 4 rreshkitese dy teke , nje ne forme spiraleje dhe nje tub gderi ne mesin e gjatesis i mbyllur . Ne mes do te jen shkallaet te cilat do te sherbejne per tu ngjitur ne loder dhe do te jen gjithsej 10 shtylla ku do te vendosen elementet zbukurues si dy catia shtepie dhe lule me ngjyra. Permasat e te gjith elementeve plotesues te kesaj loje do te jene te shenuara ne fotot ne table. Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore.



SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026


			
6	Loder me rreshkitese ne tre ane Produkti loder do te zere nje siperfaqe prej 70m2.Elementet perberes te saj si:shtyllat e galvanizuara ,rreshkiteset e drejta dhe ne forme spirale,kangjellat rrethuese,kulmet i saj ne formen e kermillit e do te jene disa nga elementet plotesuese te kesaj loje.Te gjithë elementet do t jene prej materiali Polietileni dhe te galvanizuara. Pika me e larte eshte 4.3 m nga toka dhe e gjithë struktura e lidhur do te montohet e betonizuar ne toke. Pjesa e sipërme e te gjithë shtyllave do te jete e mbyllur me tapa plastike. Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore.Te gjitha elementet e produktit do te jene sipas fotove ne tabele sebashku me permasat. 	Cope	2

SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

Loder me rreshkitese ne dy ane

Produkti loder do te zere nje siperfaqe prej 18 m2. Elementet perberes te saj si: shtyllat e galvanizuara, rreshkiteset e drejta dhe ne forme spirale, kangiellat rrethuese, kulmi i saj ne formen e nje catie do te jene elemntet plotesuese te kesaj loje. Te gjithë elementet do t jene prej materiali Polietileni. Pika me e larte eshte 4.3 m nga toka dhe e gjithë struktura e lidhur do te montohet e betonizuar ne toke. Pjesa e siperme e te gjithë shtyllave do te jete e mbyllur me tapa plastike. Te gjitha elementet e produktit do te jene sipas fotove ne tabelë.






Cope

2


SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

8	Loder rrotulluese siluetet 1.5 m e larte E cila do te montohet ne toke. Me 8 vende per femije per tu ulur , e perbere nga material polietileni dhe ne mes te ket nje bosht rrotullimi I cili do te sherbej si timon per te krijuar levijen e saj . Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregulloret ushqimore. Fotot bashkangjitur   	Cope	2
9	Kosha basketbolli sebashku me pjesen e pasme qe do te montohet ne shtylla Te jene material i forte dhe per perdorim te jashtem	Cope	4

SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije "KOLOVAJZAT 2", qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

			
10	Rrjete metalike e gomuar e cila do te perdoret per rrethimin e te gjithë hapsires ku do te vendosen lojerat. Ne pjeset gjatesore te saj do te perdoren shtylla me Ø 50 dhe 5 m te larta ndersa lidhja nga nje shtyll ne tjetren per perforcim do te behen me tuba Ø 40 , 3m. 	M1	400
11	Lyerje me bojë me bazë rezinash akrilike në dispersion ujor, per vijëzime në fusha sportive basketbolli te jashtme .	M2	375

SPECIFIKIME TEKNIKE

Parku i Lodrave per Femije “KOLOVAJZAT 2”, qyteti Erseke, bashkia Kolonje, viti 2026

Hartoi Specifikimet



Ing Muharem Tartari
Nr. Liç. K.1601/2

Marilda Vivo
Drejtoria Arsimit

DPZHT&M

MIRATOI

ERION ISAI
Kryetar i Bashkise Kolonjë



BASHKIA KOLONJE
KENDILLORRAVE DËR FENETËR,
QYTETI HESËRË BASHKIA KOLONJE
VITI 2021

Projektes

DIREKTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT
E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT


Emërimi i fletës:

DETALJET E HRRJES

1:500

A3

PROJEKT ZBATIM



BASHKIA KOLONJE
KENDI LLOKRAVE PER PENJITET
QYTETI ERSKE BASHKIA KOLONJE
VITI 2021

Projektes

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT
E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Emertimi i llojes

DETALJET E HYRSES

1:500

A3

PROJEKT ZBATIMI



BASHKIA KOLONJE
KENDI I LODRANË PËR PËNËTË,
QYTETI ERSKË BASHKIA KOLONJE
VITI 2021

Projektes

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT
E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Emërimi i llojes:

DETAJET E HYRJES

1:500 A3

PROJEKT ZBATIMI